

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS -Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Hasan Shala dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP U.C. sh.p.k me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Intellex Associates L.L.C në Prishtinë e përfaqësuar përmes av. A.B.O., G.T.dhe V.H., kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.134/2013, të datës 13.04.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.01.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Miratohet si e bazuar ankesa e të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.134/2013, i datës 13.04.2016, priset dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës se shkallës së parë.

II. Pranohet propozimi i propozueses - personit të interesuar Agjencia Kosovare e Privatizimit për ndërhyrje në anën e të paditurës.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.134/2013, të datës 13.04.2016, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, është aprovuar kërkesëpadia paditësit NTP U.C. sh.p.k me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, për anulimin e vendimit nr.03/113/2012 të datës 12.12.2012 si e bazuar. Ndërsa në pikën II të dispozitivit anulohet aktvendimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Prishtinë nr.03/113/2012 i datës 12.12.2012, dhe çështja i kthehet organit të paditur në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka ushtruar ankesë për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Duke pohuar se, aktvendimi i AKK është i bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr.04/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme sipas nenit 4 paragrafi b) dhe d) duke vendosur sipas ankesës së palës lidhur me rikthimin e të drejtës së pronës së paluajtshme bazuar në vendimin e AKP-së me nr. Ref.BD-47/3 të datës 31.05.2012 e reregjistron të drejtën e pronësisë për ngastrën Kadastrale nr.6204-11 në ZK Prishtinë, pasi që Bordi i AKP-së ka shfuqizuar privatizimin e Hotel Grandit nga N.G.H. L.L.C në emër të NSH

Slloga e njohur si KHT “Kosova” e cila tani administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Me propozim që të aprovohet ankesa dhe të shfuqizohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të vërtetohet aktvendimi me nr.03/113/2012 i datës 12.12.2012 i lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Njëherit, pala e interesuar Agjencia Kosovare e Privatizimit me datën 31.05.2016 në cilësinë e ndërhyrësit në anën e të paditurës në këtë lëndë, ka parashtruar parashtresën me propozim për ndërhyrjen e AKP-së në procedurën administrative të hapur sipas padisë së paditësit në konfliktin administrativ duke pohuar se ka interes juridik me qenë palë ndërhyrëse në anën e të paditurës në këtë procedurë të konfliktit administrativ, se nuk ka qenë në dijeni për zhvillimin e një procedure të tillë lidhur me kundërshtimin e regjistrimit të drejtave pronësore të cilat burojnë nga vendimi i Bordit të AKP-së Ref.BD-47/3 të datës 31.05.2012 për anulimin e marrëveshjes së zotimeve me numër 587/2005 të datës 10.09.2006 të lidhur në mes të ish Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) dhe Ndërmarrjes së Re Grand Hotel SHPK dhe Ndërmarrjes NTP “U.C.”. Me tej pohon se AKP ka fituar kontestin civil të hapur sipas padisë së paditësit për çështje meritore dhe se e drejta e AKP-së për anulimin e marrëveshjes së theksuar më lartë është e drejtë dhe e ligjshme, ngase është paraparë me ligj dhe në vet marrëveshjen “që eventualisht për mos përmbushjen e zotimeve do ti merren aksionet”. Këto veprime të ndërmarra nga AKP janë kontestuar nga paditësja në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme si gjykatë kompetente e cila ka vendosur në të gjitha instancat deri në plotfuqishmëri duke refuzuar kërkesëpadinë e paditëses. Prandaj AKP ka interes juridik që të vërtetohet edhe në procedurën e konfliktit administrativ vendimi i kontestuar. Propozon që të pranohet propozimi i propozueses AKP për ndërhyrjen në procedurën e konfliktit administrativ në anën e të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe të aprovohet ankesa e AKK në tërësi si e bazuar dhe të priset aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Me datën 01.12.2016 përfaqësuesi i autorizuar i paditëses av. A.B.O. është përgjigjur në parashtresën e ndërhyrësit për kundërshtimin e propozimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për ndërhyrje në procedurën administrative, duke propozuar që të refuzohet si i pabazuar propozimi i AKP që të marr pjesë si ndërhyrës në këtë proces gjyqësor.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, propozimin për ndërhyrjen e AKP-së në procedurë në anën e të paditurës, parashtresën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit për kundërshtimin e propozimit të AKP-së për ndërhyrje në procedurën administrative, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar nr.03/113/2012 të datës 12.12.2012 të Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Prishtinë, në pikën I të dispozitivit të aktvendimit është refuzuar ankesa e N.G.H. L.L.C të cilën e përfaqëson Intalex Associates L.L.C në Prishtinë e përfaqësuar përmes av. A.B.O., kundër aktvendimit me nr.011-952-1-2281 të datës 01.08.2012 të Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi të KK Prishtinës si e pabazuar. Ndërsa në

pikën II të dispozitivit të aktvendimit mbetet në fuqi aktvendimi i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi i KK Prishtinë me nr. 011-952-1-2281 i datës 01.08.2012. Me arsyetim se AKK pas shqyrtimit të provave ka konstatuar se Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi e KK në Prishtinë ka nxjerr aktvendim në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Paluajtshme sipas (nenit 4 al. b) dhe d) duke vendosur sipas detyrës zyrtare lidhur me rikthimin e të drejtës së pronës së paluajtshme bazuar në vendimin e AKP-së me nr. Ref.BD-47/3 të datës 31.05.2012 e ri regjistron të drejtën e pronësisë për ngastrën Kadastrale me nr.6204-11 të ZK Prishtinë, pasi që Bordi i AKP-së ka shfuqizuar privatizimin e Hotel Grandit nga N.G.H. L.L.C në emër të NSH Slloga e njohur si KHT “Kosova” e cila tani administrohet nga AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit. Prandaj AKK aprovon aktvendimin me numër 011-952-1-2281 të datës 01.08.2012 të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të KK Prishtinë.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm se ndryshimet në librat Kadastrale janë pa bazë ligjore, pa kushte të cilat i parasheh ligji për regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe se me këtë iu ka cenuar e drejta që të disponoj lirisht me pronën e vet. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, paraqitur kundër aktvendimit, nr.03/113/2012 të dt. 12.12.2012 të AKK-ës në Prishtinë, në seancën e shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, për shkak se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 nën par. i) dhe n), neni 183 dhe 184 i LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Sepse arsyet në të cilat bazohet për faktet vendimtare, nuk janë të qëndrueshme, së është juridikisht i paqartë dhe jo i plotë, kundërthënës me vetveten dhe arsyetimin e tij, se pse vendimi i AKP-së Ref.BD-47/3 i datës 31.05.2012 nuk mund të konsiderohet titull përmbartës, për çka në mënyrë të bazuar në ankese theksohet. Andaj kolegji i kësaj gjykatë duke pasur parasysh pretendimet ankimore dhe theksimet në parashtrësën e AKP-së me propozim për ndërhyrje në procedurë, së ka interes juridik me qenë pale ndërhyrëse, vlerëson së aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë, ngase përmban shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 21, 37, dhe 39 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Me dispozitën e nenit 21 të LKA-së, përcaktohet se, pozitën e palës në konfliktin administrativ e ka edhe personi, të cilit, anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do ti sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthorë. Në rastin konkret ky presupozim është plotësuar. Ngase pala e interesuar AKP nuk ka qenë i përfshirë dhe nuk iu ka dhënë mundësia që të jetë palë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, të cilat bëjnë shkelje esenciale të dispozitave të lartcekura që ky aktgjykim të mos mund të ekzaminohet, si i tillë se është jo i plotë për faktin se nuk janë dhënë arsye përkitazi me faktet vendimtare. Sepse në këtë çështje juridike, nuk ka qenë i përfshirë pala e interesuar, dhe nuk janë administruar në tërësi provat e nevojshme për faktet kontestuese, për tu vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike dhe për tu aplikuar drejtë dispozitat juridike materiale.

Ndërsa me dispozitën e nenit 37 par. 1 të LKA-së përcaktohet se: nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë, sipas paragrafit 2 të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji ose nuk e anulon aktin administrativ sipas nenit 35 të këtij ligji gjykata do t'ia dërgoj nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkangjitura në përgjigje palës së paditur dhe personave të interesuar. Kurse me dispozitën e nenit 39 par. 1 të LKA-së përcaktohet se gjyqtari mbikëqyrës cakton ditën e shqyrtimit dhe në shqyrtim do të ftoj palët dhe personat e interesuar. Prandaj në rastin konkret nga shkresat e lëndës rrjedh se Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të jetë në cilësinë e palës së interesuar meqenëse me vendimet e organeve administrative vendosej e drejta për regjistrimin e pronës për ngastrën Kadastrale e që njëra nga pjesëmarrëset doemos është dashtë të jetë AKP si palë e interesuar konform dispozitave ligjore të lartcekura të LKA-së. Ngase rikthimi i drejtës së pronësisë së paluajtshme në emër të ish pronarit e cila administrohet nga AKP është bërë sipas vendimit të AKP-së me numër nr. Ref.BD-47-3 të datës 31.05.2012, e cila në pajtim me dispozitat ligjore i ka bartë të drejtën e shfrytëzimit dhe posedimit.

Gjykata e shkallës së parë, siç rezultojn nga shkresat e lëndës dhe arsyetimi i aktgjykimit nuk ka ftuar palën e interesuar për shqyrtimin e kontestit edhe pse shihet qartë interesi i tij për pjesëmarrje në kontest, pasi ka të drejtë në pjesëmarrje për të mbrojtur interesat të cilat i janë përcaktuar me ligj. Pala e interesuar në konfliktin administrativ është palë, qe do të thotë se gjykata e shkallës së parë është e obliguar që t'ia dërgoj padinë në përgjigje, ajo ka të drejtë që të propozoj nxjerrjen e provave dhe të ndërmarr veprime të tjera në kontest, ka të drejtë që të marr pjesë në shqyrtimin verbal, të deklarohe për të gjitha faktet dhe çështjet juridike, dhe duhet ti dërgohet vendimi gjyqësor. Pala e interesuar gjithashtu ka të drejtë të shfrytëzimit të gjitha mjeteve juridike në konfliktin administrativ. Ajo është e autorizuar, si dhe paditësi, që në mënyrë të pavarur të ndërmarr të gjitha veprimet në kontest nën supozimin se është plotësisht e aftë për ndërmarrjen e veprimeve në kufijtë e aftësive të veprimit. Në emër të tij veprime në kontest mund të ndërmarr edhe personi i autorizuar për përfaqësimin e palës së interesuar. Prandaj, nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë nuk i ka njohur këto të drejta palës së interesuar. Meqë në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë për këtë, dhe as arsyetim se për çfarë arsye nuk ju kanë njohur këto të drejta dhe dhen mundësia që të jetë palë në procedurë. Prandaj edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht.

Si pasojë e këtyre të metave të cekura me lartë, e që janë të tilla, që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, dhe shkeljeve thelbësore të procedurës rezultojn se edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të plotë, dhe në një gjendje të tillë faktike e drejta materiale nuk është zbatuar drejtë.

Për këto arsye, në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të mënjanoh të metat e lartcekura, të kujdeset që çështja kontestuese të shqyrtohet në tersi, duke ia lejuar dhe njohur të drejtat palës së interesuar si palë në procedurë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, që ti paraqes provat e veta për vërtetimin e pretendimeve të tij. Pra, të bej vërtetimin e të gjitha fakteve të nevojshme dhe rrethanave që janë me ndikim për zgjidhjen e kontestit, që theksimet jo të plota të palëve të plotësohen me provat e tyre, si dhe dokumentacioni tjetër të cilin e posedojnë dhe të cilat gjykatës i nevojiten për zgjidhjen e kontestit, nga këto shkaqe aktgjykimi i shkallës së parë, anulohet dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Pas mënjanimit të metave të lartcekura, dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka

mundësi të bie aktgjykim të drejt e të bazuar në prova dhe në ligj në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, si dhe nenit 195 par.1 pika c) e 197 par.1 pika b), të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.182/2016, me datë 05.01.2017

Kryetari i Kolegjit
Ramiz Kuqi